



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Nr. 126 Prot.  
Tiranë, më 10/082023

Nr. 16237 Prot.  
Tiranë, më 19/8/2023

MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIM DHE SHKËMBIM INFORMACIONI

NDËRMJET

BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

DHE

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Tiranë, më 10/082023

## **BIEN DAKORD:**

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, referuar më tutje si “Palët”.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (në vijim BMP) është një institucion me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur, i cili vepron në bazë të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Misioni i Bordit të Mbikëqyrjes Publike është mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, organizatave profesionale të audituesve ligjorë si dhe organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar me qëllim përmbushjen e objektivave publike në mbështetje dhe në zbatim të ligjit, akteve nënligjore, kuadrit rregullator dhe në shërbim të interesit publik, si dhe të rrisë sigurinë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik.

Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim QKB) është institucion i administratës shtetërore dhe vepron në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. QKB-ja funksionon si një qendër e vetme për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit, si dhe regjistrimit të pronarëve përfitues, duke sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Misioni i QKB-së është ofrimi i shërbimeve të saj elektronikisht nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania me procedura të thjeshta, brenda afateve kohore të shkurtra dhe pa asnjë kosto për biznesin.

### **Neni 1**

#### **QËLLIMI I MARRËVESHJES**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është:

1. Shkëmbimi i informacionit, mbi bazën e kërkesës së dërguar nga pala kërkuese (BMP), për subjektet që mbajnë titullin “Auditues Ligjor” dhe “Kontabilist i Miratuar”, apo që mund të jetë subjekte të tjera, të cilat bien ndesh me profesionin e kontabilistit të miratuar dhe audituesit ligjor;
2. Shkëmbimi i informacionit, mbi bazën e kërkesës së dërguar nga pala kërkuese (BMP), në lidhje me subjektet të regjistruar pranë QKB, të cilët kanë depozituar informacionin vjetor në përputhje me legjislacionin, mbi audituesin ligjor, raportin e auditimit, pasqyrat financiare dhe hartuesin e pasqyrave financiare, me qëllim kryqëzimin e informacionit të depozituar pranë BMP;
3. Shkëmbimi i informacionit, mbi bazën e kërkesës së dërguar nga pala kërkuese (BMP), për të gjithë subjektet shoqëri juridike/ persona fizikë të cilët kanë depozituar pranë Regjistrimit Tregtar, pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e auditimit;
4. Shkëmbimi i informacionit, mbi bazën e kërkesës së dërguar nga pala kërkuese (BMP), lidhur me pasqyrat financiare të audituara, dhe nxjerrja e të dhënave statistikore si totali aktiveve, totali i të ardhurave, numri mesatar i punonjësve, etj.;

5. Shkëmbimi i informacionit, mbi bazën e kërkesës së dërguar nga pala kërkuese (BMP), lidhur me audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit, kontabilistët e miratuar/ shoqëritë e kontabilitetit, që kanë të drejtë të ofrojnë shërbimet e përcaktuara në ligjin e auditimit.

## **Neni 2**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje është e bazuar në Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, miratuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, Ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

## **Neni 3**

### **PARIMET E MARRËVESHJES**

Bashkëpunimi i palëve në kuadër të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim të së cilave lidhet kjo marrëveshje;
2. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë;
3. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve;
4. Institucionet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunim, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatore. Kërkesa mund të mos plotësohet kur:
  - i. informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit;
  - ii. kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje;
5. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i rregullt i informacionit nëpërmjet komunikimit dhe takimeve të rregullta, në mënyrë që secila palë të përmbushë përgjegjësitë e saj ligjore;
6. Bashkëpunimi në lidhje me dhënien e informacionit nga QKB-ja, mbi depozitimin e pasqyrave financiare të hartuara, në rastet kur BMP-ja konstaton se subjekti nuk është i pajisur me një licencë sipas legjislacionit në fuqi dhe që ofrojnë shërbimet e Audituesit Ligjor ose Kontabilistit të Miratuar.
7. Përcaktimi i saktë i përgjegjësisë, duke u mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues, duke siguruar kështu rritjen e efikasitetit dhe të përgjegjshmërisë së palëve për veprimet e kryera, në raport me çështjet që trajtohen.

## Neni 4

### PROCEDURA PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT

1. Në përputhje me ligjin, palët do të bashkëpunojnë për të mbledhur dhe analizuar informacionin që disponojnë dhe vënien në dispozicion të tij zyrtarisht me shkrim.
2. Informacioni ose dokumentet e marra nga palët është/janë konfidenciale dhe nuk do t'i shpërndahen palëve të treta, pa miratimin paraprak me shkrim të palëve në këtë marrëveshje, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.
3. Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo dhënien e çdo informacioni ose dokumenti të marrë nga palët përkatëse për qëllime të tjera nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.
4. Për të lehtësuar komunikimin dhe për të siguruar vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërmjet palëve, çdo palë cakton personin e kontaktit të përcaktuar në nenin 7, për komunikimet sipas këtij marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni.
5. Pala kërkuese do të bëjë kërkesën për informacion me shkrim drejtuar personit të kontaktit të palës tjetër.
6. Kërkesa do të përfshijë:
  - a) një përshkrim të objektit të kërkesës dhe qëllimit për të cilin pala kërkuese kërkon informacionin;
  - b) një përshkrim të dokumentacionit ose informacionit të kërkuar nga pala kërkuese (vetëm në rastin kur dokumenti dhe informacioni i kërkuar, nuk figuron i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit ([www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al)));
  - c) çdo informacion që disponon pala kërkuese që mund të ndihmojë palën e kërkuar në identifikimin e personave, organeve ose subjekteve që besohet nga pala kërkuese se zotërojnë informacionin e kërkuar, ose vendet ku pala e kërkuar mund të marrë një informacion të tillë;
  - d) dispozitat ligjore në lidhje me çështjen që është objekt i kërkesës dhe lidhjen e informacionit të kërkuar me ligjet dhe kërkesat rregullatore të specifikuar;
7. Në rrethana urgjente, pala e kërkuar do të pranojë një kërkesë për informacion dhe do të përshpejtojë, për aq sa është e mundur, një përgjigje ndaj saj me procedura të përmbledhura ose nëpërmjet komunikimit elektronik. Këto komunikime urgjente duhet të konfirmohen me shkrim nga personat e kontaktit të përcaktuar në nenin 7 brenda 10 ditëve të punës.

## Neni 5

### EKZEKUTIMI I KËRKESËS

1. Kur palës së kërkuar i paraqitet një kërkesë që është në përputhje me këtë marrëveshje bashkëpunimi si dhe me kuadrin rregullator që rregullojnë fushat përkatëse, pala e kërkuar:
  - a. jep informacionin e mbajtur në dosjet e palës së kërkuar;
  - b. merr informacion, duke përfshirë deklarata dhe dëshmi, dhe mbledh dokumentacionin në përputhje me ligjet dhe procedurat në juridiksionin e palëve.
2. Çdo kërkesë do të vlerësohet rast pas rasti nga pala e kërkuar për të përcaktuar nëse informacioni mund të sigurohet sipas kushteve të këtij marrëveshje bashkëpunimi.

## Neni 6

### TË DREJTAT E PALËS SË KËRKUAR

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë kërkesat për informacion sipas marrëveshjes së të bashkëpunimit:
  - a) kur kërkesa do t'i kërkonte palës së kërkuar të vepronte në një mënyrë që do të shkelte ligjet e juridiksionit përkatës;
  - b) kur kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e këtij marrëveshje bashkëpunimi;
  - c) për arsye të interesit publik.
2. Kur pala e kërkuar refuzon një kërkesë për informacion dhe bashkëpunim, ose kur ky informacion nuk është i disponueshëm sipas ligjit të juridiksionit përkatës, pala e kërkuar do të japë arsyet pse nuk po jep informacionin.

## Neni 7

### PERSONAT E KONTAKTIT

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj marrëveshje, palët përcaktojnë personat e kontaktit, dhe të gjitha komunikimet ndërmjet palëve do të realizohen nëpërmjet tyre, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe. Personat e kontaktit nuk janë domosdoshmërisht titullarët e institucionit, por caktohen nga këta të fundit, sipas rastit. Personat e kontaktit sipas palëve do të jenë si më poshtë:

BMP - përfaqësohet nga:

Klea Rodhani

Specialist i Çështjeve Ligjore

Email: [klea.rodhani@bmp.al](mailto:klea.rodhani@bmp.al)

QKB - përfaqësohet nga:

Laureta Kroj

Specialist në Drejtorinë e Regjistrave dhe Analizës.

Email: [laureta.kroj@qkb.gov.al](mailto:laureta.kroj@qkb.gov.al)

## Neni 8

### SHQYRTIMI I MARRËVESHJES

Institucionet nënshkruese rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe konsultojnë atë me synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin.

## Neni 9

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen BMP dhe QKB me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje.
2. Çdo rregullim ose ndryshim, sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshje, bëhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve dhe me shkrim.
3. Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.
4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
5. Marrëveshja mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.

#### Neni 10

#### PUBLIKIMI

Palët bien dakord që kjo marrëveshje bashkëpunimi do të publikohet në faqet zyrtare të secilës palë.

#### Neni 11

#### HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.

Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në original.

Kjo marrëveshje përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) nene, 6 (gjashtë) faqe.

Nënshkruar sot, më datë 10 / 08 / 2023, në Tiranë.

#### BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KRYETAR



#### QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

